

APROVIMI I RENDIT TË DITËS

Në të gjitha mbledhjet e KGJK-së është miratuar agjenda nga të gjithë anëtarët.

Pikat e mbyllura të rendit të ditës




Tabela 5: Pikat e mbyllura të rendit të ditës të paraqitura për secilin muaj të monitorimit.

ANËTARËT MË AKTIV TË KËSHILLIT GJYQËSOR

Anëtarët më aktiv gjatë mbledhjeve të KGJK-së

1	Makifete Saliuka
2	Armend Berisha
3	Cerim Fazliji
4	Muhamet Rexha

Tabela 6: Anëtarët që ishin më aktiv në mbledhjet e KGJK-së.

Aktiviteti i anëtarëve të KGJK-së në këto takime është vlerësuar në bazë të asaj se sa herë kanë diskutuar gjatë takimit dhe nëse diskutimi i tyre ka qenë relevant me pikën/at e agjendës së takimit. Pavarësisht që kryesuesi i KGJK-së, z. Skender Çoçaj, ka qenë më aktiv gjatë gjithë takimeve, ne nuk e kemi pasqyruar në tabelë, pasi që si kryesues ka për obligim t'i udhëheq të gjitha takimet e Këshillit.

PËRKTHIMI GJATË MBLEDHJEVE TË KGJK-së

Përkthimi gjatë mbledhjeve të KGJK-së




Tabela 7: Sigurimi përkthimit në mbledhjet e KGJK-së.

Duhet të theksojmë që ka pasur gjithmonë përkthim gjatë shtatë takimeve të monitoruara, mirëpo në katër prej tyre nuk ka pasur pajisje të përkthimit për të gjithë të pranishmit.

MBAJTJA DHE PUBLIKIMI I PROCESVERBALEVE TË TAKIMEVE

Sa i përket proces verbaleve të takimeve të KGJK-së nga monitorimi ynë është vërejtur që procesverbalet dhe janë mbajtur dhe publikuar në faqen e internetit të KGJK-së.

PUBLIKIMI I VENDIMEVE QË VIJNË NGA TAKIMET E KGJK-së

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës përcakton se vendimet dhe të gjitha politikat e miratuara nga takimet e Këshillit duhet të publikohen në faqen zyrtare të tij brenda pesë ditëve nga miratimi i tyre.³ KGJK përgjatë periudhës monitoruese nga 1 maj – 15 nëntor 2019, i ka publikuar vendimet në kohë, me përjashtim të një vendimi të datës 21 qershor i cili ka tejkaluar afatin e publikimit të paraparë me ligj.

³ Ky ligj nuk specifikon që afati pesë ditorë për publikimin e vendimeve në faqen zyrtare nënkupton afatin pesë ditë pune ose jo.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

FOL



PROGRAMI PËR FUQIZIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË MONITORIMI I TAKIMEVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Ky monitorim është realizuar me përkrahjen e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij monitorimi është përgjegjësi vetëm e Lëvizjes FOL dhe jo domosdoshmërisht reflekton këndvështrimet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

MONITORIMI I TAKIMEVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Lëvizja FOL me mbështetjen e Programit të USAID për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë gjatë periudhës e maj – 15 nëntor, 2019 ka monitoruar takimet dhe vendimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për të vlerësuar pajtueshmërinë dhe nivelin e transparencës me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.¹

Procesi i monitorimit është bërë përmes metodës së monitorimit direkt - duke monitoruar takimet e KGJK-së dhe mbarëvajtjen e tyre dhe po ashtu përmes monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KGJK-së – ku është monitoruar nëse procesverbalet, vendimet, dhe rregulloret janë publikuar pas takimeve të Këshillit.

GJETJET NGA MONITORIMI I TAKIMEVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

NUMRI I TAKIMEVE TË KGJK-SË

Gjatë periudhës së monitorimit, KGJK nga muaji qershor deri me 15 nëntor i ka mbajtur gjithsej 8 takime. Njëra prej tri takimeve të muajit qershor (i datës 28 qershor 2019) nuk është monitoruar pasi që Lëvizja FOL nuk e ka marr ftesë për takim si dhe njoftimi për të nuk është shpallur në faqen zyrtare të KGJK-së.

¹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës. LIGJI Nr. 06/L 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Dhjetor 2018.

Numri i takimeve të KGJK-së qershor - 15 nëntor, 2019





Tabela 1: Takimet e KGJK-së gjatë periudhës monitoruese qershor – 15 nëntor 2019.

PUBLIKIMI I AGJENDËS BRENDA AFATIT KOHOR

Prej tetë agjendave të publikuara në faqen e internetit të KGJK-së, vetëm gjysma e tyre janë publikuar me kohë ashtu si e obligon Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.²

Publikimi i agjendes në faqen e internetit të KGJK-së



- Agjenda është publikuar me kohë
- Agjenda nuk është publikuar me kohë

Tabela 2: Publikimi me kohë ose jo i agjendës në faqen zyrtare të KGJK-së ashtu si e parasheh ligji.

² Ibid.

RESPEKTIMI I PËRDORIMIT TË GJUHËVE ZYRTARE

Të gjitha agjendat e publikuara në faqen zyrtare të KGJK-së janë publikuar në gjuhët zyrtare, në gjuhën shqipe dhe serbe.

Prezenca e anëtarëve në takimet e KGJK-së

Muaji	12 Qershor	21 Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	7 Tetor	25 Tetor	Nëntor
Anëtarët prezent	10	10	10	N/A	9	9	11	10
Anëtarët jo prezent	1	1	1	N/A	2	2	0	1

Tabela 3: Numri i anëtarëve që kanë qenë prezent ose jo në takimet e KGJK-së.

MESATARJA E VONESAVE TË TAKIMEVE TË KGJK-SË

Mesatarja e vonesave së takimeve të KGJK-së është rreth 5 minuta. Në tabelën e mëposhtme nga llogaritja e mesatares së vonesave janë përjashtuar tri takime, dy prej të cilave kanë filluar me kohë dhe një nuk është monitoruar pasi që FOL nuk është informuar për mbajtjen e takimit, i cili po ashtu nuk është shpallur në faqen e internetit të KGJK-së.

Vonesat e takimeve të KGJK-së të shprehura në minuta

Datat e takimeve të KGJK-së	12.06.2019	21.06.2019	31.07.2019	05.09.2019	07.10.2019	25.10.2019	06.11.2019
PO		8		6	10	8	
JO	0		0				0

Tabela 4: Vonesat e takimeve të KGJK-së të shprehura në minuta.